

VENDIM
Nr. 102, datë 1.3.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 224, DATË 21.3.2017, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHTESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe të nenit 20, të ligjit nr. 9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 224, datë 21.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr. 1 “Paga bazë sipas gradës dhe viteve të shërbimit për ushtarakët aktivë të Forcave të Armatosura” zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2023, të përballohen nga fondet e miratuara për paga dhe sigurime shoqërore për sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes, për këtë vit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 mars 2023.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

PAGA BAZË SIPAS GRADËS DHE VITEVE TË SHËRBIMIT PËR USHTARAKËT AKTIVË TË FORCAVE TË ARMATOSURA

OFICERË	Vitet e shërbimit															Mbi 26 vjet
	Nën 1 vit	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet	
Gj.Lejtnant (Admiral)																217.000
Gj.Major (Nënadmiral)																207.000
Gj.Brigade (Kundëradmiral)																175.000
Kolonel (Kapiten i rangut I)														147.700	150.700	153.000
Nënkolonel (Kapiten i rangut II)												120.600	122.500	124.500	126.500	128.400
Major (Kapiten i rangut III)									95.700	98.200	99.800	102.100	103.600	105.300	107.800	109.400
Kapiten (Kapiten lejtnant)						85.500	86.900	89.000	90.800	91.800						
Toger (Lejtnant)				80.400	81.700	83.200	85.200	86.250	88.500	90.100						
Nëntoger (Nënlejtnant)	77.340	77.900	79.150	80.400	81.500	82.100	84.000									
NËNOFICERË	Vitet e shërbimit															Mbi 26 vjet
	Nën 2 vjet	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet	Mbi 16 vjet	Mbi 18 vjet	Mbi 20 vjet	Mbi 22 vjet	Mbi 24 vjet		
K/Kapter												82.800	84.300	86.900	88.600	90.100
Kapter									73.000	74.500	76.000	77.600	79.300	81.600	83.200	84.700
Rreshter							67.000	68.700	70.800	72.700	77.400	75.800	77.200			
Tetar							64.950	66.500	67.200	68.900						
Nëntetar					60.800	62.000	63.600	64.300	65.700	67.500						
USHTARË AKTIVË	Vitet e shërbimit															Mbi 26 vjet
	Nën 1 vit	Mbi 1 vit	Mbi 2 vjet	Mbi 3 vjet	Mbi 4 vjet	Mbi 5 vjet	Mbi 6 vjet	Mbi 8 vjet	Mbi 10 vjet	Mbi 12 vjet	Mbi 14 vjet					
Ushtar profesionist II/ detar profesionist II			58.400	59.000	59.800	60.400	61.200	62.600	63.850	65.400	66.800					
Ushtar profesionist I/ detar profesionist I		56.900	57.750													
Ushtar rekrut II/ detar II	55.640	56.350														
Ushtar rekrut I/ detar I	54.700															